

KOMUNA E MITROVICËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Mitrovicës udhëhiqet nga Agim Bahtiri nga Aleanca Kosova e Re . Ky është mandati i tij i parë si kryetar i komunës.

Në zgjedhjet e fundit për kryetar të komunës (nëntor 2013), Bahtiri ka fituar në balotazh ndaj Avni Kastratit nga Partia Demokratike e Kosovës . Ky i fundit në raundin e parë ka siguruar 12,608 vota (apo 42.6%) ndërsa Bahtiri ka pasur 6,483 vota (apo 21.9%).¹ Ndërkaq në balotazh Bahtiri ka siguruar 52.3% të votave.²

Në zgjedhjet e kaluara lokale , kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.³ Sipas një studimi të UNDP-së, 98% e qytetarëve të Mitrovicës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.⁴ Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Mitrovicës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar të

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (hapur së fundi më 22 qershor 2017).

² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetari Komune – Raundi II. Burimi: <http://bit.ly/2g1luYl> (hapur së fundi më 22 qershor 2017).

³ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

kënaqshmërisë nga -3.60 pikë në vitin 2012 në -28.07 në vitin 2015, një trend negativ me diferencë prej -24.47 pikë.⁵

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Mitrovicës. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: rrugë të dëmtuara në qytet, menaxhimi i mbeturinave, ndotja e ambientit, mungesa e ujit të pijes, mbeturina në lumin Trepça, mungesa e ndriçimit publik, rregulli në administratë – mbingarkesa me staf dhe faturat e papaguara të komunës.⁶ Përveç disa nga problemet e cekura më lartë të cilat ende vazhdojnë të theksohen si probleme në Mitrovicë (si mungesa e ndriçimit të plotë publik, ndotja e lumenjve, mbingarkesa me staf në administratë), këtë vit qytetarët e Mitrovicës kanë identifikuar si problematike edhe mungesën e parkingjeve publike, mungesën e transportit publik, mungesën e çerdheve publike, ndotjen e ambientit dhe papastërtinë e rrugëve.

Problemet kryesore në Komunën e Mitrovicës

Mungesa e parkingjeve publike. Mungesa e parkingjeve publike në qytet është vlerësuar si një prej problemeve nga qytetarët e Mitrovicës. Ende nuk ka një pjesë të dedikuar për parking publik por pjesë të ndryshme gjatë rrugëve nëpër qytet përdoren si vend parkime. Në disa pjesë ekzistojnë parkingje private dhe disa pjesë përgjatë rrugëve i janë lëshuar me qira nga komuna disa kompanive të taksive që operojnë në Mitrovicë. Pjesa ku qytetarët më së shumti e frekuentojnë për parkim pa pagesë është pjesa afër sallës së sportit Minatori. Parkimi i veturave në pjesë të ndryshme të qytetit është duke shkaktuar edhe një kaos në trafik dhe zënie të hapësirave për këmbësorë.

Mungesa e transportit publik. Mungesa e transportit të organizuar publik është një prej problemeve që është theksuar nga qytetarët e Mitrovicës. Në fillim të mandatit të Agim Bahtirit, një numër i autobusëve donacion finlandez ishin dhënë për komunën e Mitrovicës me qëllim të organizimit të transportit publik nga komuna. Kjo nuk është realizuar gjatë mandatit dhe më vonë këta autobusë i janë falur klubeve sportive në Mitrovicë. Transporti në Mitrovicë është i organizuar nga atuomjete private të cilat operojnë nëpër qytet derisa në fshatra transporti është i organizuar me autobus privat.

⁵ Ibid. faqe 39

⁶ Instituti GAP, Komuna e Mitrovicës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor, shtator 2013. Burimi: <http://bit.ly/2rVaul0>).

Mungesa e çerdheve publike. Në komunën e Mitrovicës ekziston vetëm një çerdhe publike dhe katër të tjera janë private. Pastaj, çerdhja e vetme publike "Gëzimi ynë" që menaxhohet nga drejtoria e arsimit në komunën e Mitrovicës duhet rinovuar sepse janë identifikuar një numër problemesh me kanalizim, vjetërsi të infrastrukturës së objektit, etj.

Papastërtia e rrugëve dhe ndotja e ambientit. Rrugët në qytetin e Mitrovicës fare pak pastrohen nga pluhuri që mblidhet anash rrugëve dhe kjo shkakton papastërti të rrugëve dhe rrjedhimisht edhe ndotje të ambientit nga pluhuri. Në Mitrovicë ka po ashtu nevojë për hapësira më të mëdha gjelbërimi. Në Mitrovicë ende vazhdojnë deponitë/mbetjet e plumbit nga koha e para luftës kur në funksion ka qenë fabrika Trepça me të gjitha njësitë e saj. Këto mbetje sidomos shkaktojnë probleme në kontaminim të ujit në hapësirat përreth tyre por edhe gjatë erërave të forta të cilat e shpërndajnë këtë mbetje edhe më gjerë.

Ndriçimi publik. Shtrirja e plotë e ndriçimit publik ishte nxjerrë si një prej problemeve në Mitrovicë edhe në raportin e ngjashëm të vitit 2013. Nga ajo kohë, ka disa përmirësime sepse disa rrugë që më 2013 janë identifikuar pa ndriçim, tani ndriçimi është shtrirë në ato pjesë/rrugë. Megjithatë, janë identifikuar edhe një numër i rrugëve në lagje të mëdha në Mitrovicë të cilat janë pa ndriçim. Kryesisht janë rrugë dytësore të cilat lidhen me një apo tjetër rrugë kryesore në Mitrovicë. Për shembull, në lagjen "Ilirida", përgjatë rrugës "Xhevat Jusufi" janë identifikuar këto rrugë pa ndriçim publik: Rr. Xhevat Ferizi, Rr. Rustem Suhodolli, Rr. Gavaz Bajgora, Rr. Jashar Boletini, Rr. Fuad Barani, Rr. Bajram Curri. Në lagjen "Bair" janë identifikuar po ashtu disa rrugë pa ndriçim publik, si Rr. Migjeni, Rr. Zahir Pajaziti, Rr. Konstandin Kristoforidhi, Rr. Sylejman Shala, Rr. Shote Galica pastaj Rr. Lina Shkreli afër Gjimnazit "Frang Bardhi". Në lagjen "2 Korriku" është identifikuar Rr. Kalabria e cila vazhdon të jetë e pa shtruar dhe pa ndriçim.⁷

Ndotja e lumenjve. Ndotja e lumenjve është po ashtu një problem tjetër i cili është theksuar dhe identifikuar edhe më 2013. Mitrovica ka katër lumenjë: Ibri, Sitnica, Lushta dhe Trepça. Ndotje është vërejtur sidomos e lumit Trepça edhe pjesa e bashkimit me lumin Sitnica dhe pastaj lumi Lushta. Në të dy lumenjtë vërehen mbeturina të hedhura dhe që mbesin në ujë dhe shkaktojnë kundërmim për qytetaret, sidomos për banorët në afërsi të lumit Lushta.

Mbingarkesa me staf e administratës komunale. Rregulli në administratë dhe mbingarkesa me staf është theksuar si problem edhe në raportin e vitit 2013. Përveç numrit të madh të nëpunësve civil

⁷ Verifikuar më 21 qershor 2017 në Mitrovicë.

krahasuar me numrin e banorëve që ka komuna e Mitrovicës, në administratë ekziston edhe një numër i madh i punëtorëve me kontratë mbi vepër. Sipas vlerësimeve të OJQ-ve dhe medieve lokale në Mitrovicë, numri i punëtorëve me kontratë mbi vepër është 41. Madje sipas raportit të auditorit të përgjithshëm për komunën e Mitrovicës, një numër prej 15 punëtorëve të marrë me kontratë mbi vepër, ishin pranuar në punë pa përfillur as procedurat e thjeshtëzuara që kërkohen me Udhëzim Administrativ.⁸

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Lirimi i hapësirave të uzurpuara në afërsi të shkollave

Një pjesë e konsiderueshme e shkollave të Mitrovicës përballen tash e sa vite me problemin e uzurpimeve të hapësirave të tyre nga banorët që jetojnë në afërsi të këtyre shkollave. Në gusht të 2017 ka ndodhur një rast kur nga djegia e një shtëpie private në afërsi të shkollës "Musa Hoti" në Bair flakët kanë përfshirë edhe objektin e shkollës duke u djegur i tëri. Shkolla ka pasur objekt të ri financim nga BE-ja. Shkaktimi i zjarrit ka ardhur ngase pronari i shtëpisë në mënyrë të paligjshme ka ngjitur shtëpinë e tij me objektin e shkollës. Ky nuk është rasti i vetëm në Mitrovicë kur shtëpitë private janë ndërtuar krejt afër shkollave duke shfrytëzuar hapësirën që ka qene e dedikuar për shkolla. Komuna do të duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj çështje dhe të mos lejojë përsëritjen e rasteve sikur ai ne lagjen Bair.

Ndërtimi i hapësirave sportive

Komuna e Mitrovicës në të gjitha zonat ka mungesa të hapësirave rekreative sportive. Komuna do të duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj sferë dhe në të ardhmen të parashohë krijimin e kushteve për rekreacion dhe sport se paku në zonat kryesore të qytetit. Përveç kësaj, komuna do të duhej t'i kushtojë vëmendje edhe ngritjes së këndeve të lojërave për fëmijë.

Trendet buxhetore në Komunën e Mitrovicës (2017)


Komuna e Mitrovicës në vitin 2017 ka planifikuar 16.7 milionë euro buxhet.⁹ Përveç të hyrave të rregullta, nga viti i kaluar janë bartur të hyra vetanake rreth 334 mijë euro, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur rreth 236

⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i Auditimit për raportin vjetor financiar vjetor të Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2tRXwal> (hapur së fundi më 23 qershor 2017).

⁹ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2sXqsjV>


mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, buxheti i komunës së Mitrovicës është rritur për 1.6 milionë euro (10%). Kjo kryesisht për shkak të rritjes së transfereve qeveritare dhe një rritje të lehtë në planifikimin e të hyrave vetanake.

Figura nr.1: Buxheti i komunës së Mitrovicës 2017




Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Mitrovicës ka një buxhet më të lartë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për 2.7 milionë euro (31%) derisa një buxhet më të ulët në kategorinë e investimeve kapitale për 874 mijë euro (-23%). Për shembull, në vitin 2013, për paga janë ndarë rreth 8,7 milionë euro (apo 58% e buxhetit total), përderisa në 2017 ky buxhet është 11.4 milionë euro (apo 76% e buxhetit total). Kjo për shkak të rritjes së pagave në administratë publike nga ana e Qeverisë së Kosovës në vitin 2014 dhe rritjes së numrit të të punësuarve për 51 persona. Në kategorinë e investimeve kapitale, në 2013, Mitrovica ka pasur 3.8 milion euro (apo 25%) e buxhetit total ndërsa në 2017 janë ndarë rreth 3 milion euro (apo 20% e buxhetit total).

Figura nr.2: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Mitrovicës në vitin 2016 ka shënuar përparim sa i përket rritjes se të hyrave vetanake komunale. Kësisoj, gjatë 2016 janë realizuar 2 milion euro të hyra, kjo shumë është për 730 mijë euro më e madhe se të hyrat e realizuara në vitin 2013.


Figura nr.3: Të hyrat komunale në 2016 sipas kategorive



Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Mitrovicës duhet të fillojë evidentimin e pronave të uzurpuara në afërsi të shkollave.
- Komuna e Mitrovicës duhet të fillojë aksione përkatëse për rrënimin e objekteve që janë bërë ngjitur objekteve shkollore për



t'i shmangur rastet si ai i gushtit 2017 kur shkolla e re në lagjen Bair është djegur tërësisht nga zjarri që ka përfshirë një objekt privat ngjitur shkollës.

- Komuna e Mitrovicës duhet të shoh me prioritet ndërtimin e çerdheve për fëmijë në qytet.
- Komuna e Mitrovicës duhet të konsiderojë mundësinë e zhvillimit të disa projekteve në komunë me partneritet publiko-privat.
- Komuna e Mitrovicës duhet të zgjerojë rrjetin e ndriçimit publik veçmas në zonat e lartcekura të kategoria e problemeve komunale.
- Komuna e Mitrovicës duhet t'i rrisë investimet në ndërtimin e hapësirave sportive për të rinj dhe hapësirave të lojërave për fëmijë.
- Komuna duhet të fillojë implementimin e projekteve që do të zbusnin gjendjen e keqe nga mungesa e parkingjeve për automjete në qytet.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world